

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA "Aquila Company" SHPK

Sot me date 26/09/2024 une ortakı i vetem : Z. LORIS DALL'AVA, i ditëlindjes 22.04.1972 ,lindur ne Milano,Itali, banues ne Milano,Itali i pajisur me pashaporte me nr CA38292FF.

Ne baze te ligjit nr . 9901 date 14.04.2008 'Per tregtaret dhe shoqerite tregtare' dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 'Per qendren kombetare te regjistrimit ' kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "Aquila Company " SHPK.

Neni 1 :

Emertimi i shoqerise

Shoqeria do te quhet "Aquila Company" SHPK dhe eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar .Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti , ligjit nr.9901 date 14.04.2008 si edhe ligjit per QKR.

Neni 2

Selia e shoqërisë

Shoqeria do te kete seline e saj ne Rruga Sukth Maminas,Borake – Nr pasurie 39/62, zona kadastrale 1242. Shoqeria mund te krijoje dege , filiale , zyra përfaqësim ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj: Projektme mekanike, karpenterie metalike si edhe cfardo lloj operacioni tregtar,financiar,qe do te konsiderohet I nevojshem ose I dobishem per arritjen e objektivit te shoqerise.

Neni 4

Kapitali i shoqërisë



Kapitali i shoqërisë "Aquila Company" shpk do të jetë 100.000 Leke .

Ky kapital përbehet nga 1 (nje) kuote dhe zoterohet në masën 100 % nga ortakut i vetëm LORIS DALL'AVA.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të pacaktuar .

Neni 6

Organet e shoqërisë

1.Asambleja e përgjithshme

2.Administratori

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- Percaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar.
- Percaktimin e shpërblimeve për administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- Perfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese.
- Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

ADMINISTRATORI



Administrator i shoqerise do te jete Z. LORIS DALL'AVA, i ditëlindjes 22.04.1972 , lindur ne Milano,Itali, banues ne Milano,Itali i pajisur me pashaporte me nr CA38292FF, i cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte riparteritje te ketij afati.

NENI 7

Shperndarja e fitimit vjetor të shoqerise

Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakëve pjesën e fitimit ne raport me vleren e kapitalit të regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqësojnë.

Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime të tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

NENI 8

Prishja e shoqerise.

Shoqeria priset :

- a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b)me vendim te asamblese se pergjithshme,
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit,
- ç)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 per "OKR",
- d) me vendim te giykates,
- dh) per arsye te tjera te parashikuara ne statut.

NENI 9

Likuidimi I shoqerise.

Ne rast te likuidimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emeron nje likuidator, I cili administron shoqerine deri ne mbylljen e progesit te likuidimit.

Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise,likuidatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje



e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy here kete njoftim, me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit, si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

NENI 10

Perfundimi i likuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershtohet pas cregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

Ortaku Themelues i Shoqerise "Aquila Company" SHPK

LORIS DALL'AVA

